



www.qbz.gov.al

Buletini i Njoftimeve Zyrtare I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË



Viti: 2018 – Numri: 44

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Tiranë – E hënë, 5 nëntor 2018

PËRMBAJTJA

Faqe

Kërkesë e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 6180, datë 26.10.2018	Për shprehje interesi për shërbimin e konsulencës “Vlerësimi i gjendjes aktuale të përfituesve ekzistues të PAK-së, bazuar në analizën e të dhënave të siguruara nga baza e ngritur për të dhënat e PAK-së (kategoritë përfituese, niveli i përfitimit, dokumentacioni ligjor dhe mjekësor etj.)”, përfitues i së cilës është Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.....	3
Njoftim i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 1065, datë 30.10.2018	Për shitje me ankand të pronës shtetërore në administrim të Institutit të Përgatitjes së Qenve të Policisë, Tiranë.....	4
Njoftim i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 1065, datë 30.10.2018	Për shitje me ankand të pronës shtetërore në administrim të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural; të Bashkisë Bajram Curri; të shoqërisë “Albminiera” sh.a.; të Drejtorisë së Përgjithshme të Rezervave Materiale të Shtetit, si dhe të Bashkisë Përmet.....	5
Njoftim i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 1072, datë 30.10.2018	Për shitje me ankand të pronës shtetërore në administrim të Drejtorisë së Përgjithshme të Rezervave Materiale të Shtetit.....	7
Kërkesë e Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit, Pyjeve, Ujërave dhe Turizmit, Dega Rajonale e Qarkut Tiranë, nr. 1871, datë 1.11.2018	Për botimin e vendimit për dënim administrativ ndaj subjektit “Lirie Bakiri”, me NIPT: L52109129A.....	8
Kërkesë e Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit, Pyjeve, Ujërave dhe Turizmit, Dega Rajonale e Qarkut Tiranë, nr. 1872, datë 1.11.2018	Për botimin e vendimit për dënim administrativ ndaj subjektit “IN-MA” sh.p.k.....	10

Kërkesë e Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit, Pyjeve, Ujërave dhe Turizmit, Dega Rajonale e Qarkut Tiranë, nr. 1873, datë 1.11.2018	Për botimin e vendimit për dënim administrativ ndaj subjektit “Bar Te Latin Dance Center”.....	11
Kërkesë e Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit, Pyjeve, Ujërave dhe Turizmit, Dega Rajonale e Qarkut Tiranë, nr. 1874, datë 1.11.2018	Për botimin e vendimit për dënim administrativ ndaj subjektit “Gëzim Jonuzaj”.....	12
Kërkesë e Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit, Pyjeve, Ujërave dhe Turizmit, Dega Rajonale e Qarkut Tiranë, nr. 1875, datë 1.11.2018	Për botimin e vendimit për dënim administrativ ndaj subjektit “Gëzim Morinaj”.....	13
Kërkesë e Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit, Pyjeve, Ujërave dhe Turizmit, Dega Rajonale e Qarkut Tiranë, nr. 1876, datë 1.11.2018	Për botimin e vendimit për dënim administrativ ndaj subjektit “Agels Albania”, me NIPT: L41321040V.....	14
Kërkesë e Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit, Pyjeve, Ujërave dhe Turizmit, Dega Rajonale e Qarkut Tiranë, nr. 1877, datë 1.11.2018	Për botimin e vendimit për dënim administrativ ndaj subjektit “American Water” sh.p.k., me NIPT: K82005012K.....	15
Kërkesë e Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit, Pyjeve, Ujërave dhe Turizmit, Dega Rajonale e Qarkut Tiranë, nr. 1878, datë 1.11.2018	Për botimin e vendimit për dënim administrativ ndaj subjektit “Liljana Ibrahim”, me NIPT: L41603040J.....	17
Kërkesë e Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit, Pyjeve, Ujërave dhe Turizmit, Dega Rajonale e Qarkut Tiranë, nr. 1879, datë 1.11.2018	Për botimin e vendimit për dënim administrativ ndaj subjektit “Sina Konstruktion 2008” sh.p.k., me NIPT: K71420002J.....	18
Kërkesë e Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit, Pyjeve, Ujërave dhe Turizmit, Dega Rajonale e Qarkut Tiranë, nr. 1880, datë 1.11.2018	Për botimin e vendimit për dënim administrativ ndaj subjektit “Irfan Aliçka”, me NIPT: K61905029S.....	19
Kërkesë e Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit, Pyjeve, Ujërave dhe Turizmit, Dega Rajonale e Qarkut Tiranë, nr. 1881, datë 1.11.2018	Për botimin e vendimit për dënim administrativ ndaj subjektit “NATSKY” sh.p.k., me NIPT: L42216033M.....	20
Kërkesë e Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit, Pyjeve, Ujërave dhe Turizmit, Dega Rajonale e Qarkut Tiranë, nr. 1882, datë 1.11.2018	Për botimin e vendimit për dënim administrativ ndaj subjektit “F.P.M.” sh.p.k., me NIPT: K11812001N.....	21

**KËRKESË****Nr. 6180, datë 26.10.2018**

**PËR SHPREHJE INTERESI PËR
SHËRBIMIN E KONSULENCËS
“VLERËSIMI I GJENDJES AKTUALE TË
PËRFITUESVE EKZISTUES TË PAK-së,
BAZUAR NË ANALIZËN E TË
DHËNAVE TË SIGURUARA NGA BAZA
E NGRITUR PËR TË DHËNAT E PAK-së
(KATEGORITË PËRFITUESE, NIVELI I
PËRFITIMIT, DOKUMENTACIONI
LIGJOR DHE MJEKËSOR ETJ.)”,
PËRFITUES I SË CILËS ËSHTË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE
MBROJTJES SOCIALE
- REF. NO. SAMP/CS/CQ/03-2016-B**

Tiranë, më 24.10.2018

*Republika e Shqipërisë**Projekti i Modernizimit të Asistencës Sociale**Huaja nr. 8141-AL**Project ID No. P122233*

Republika e Shqipërisë ka marrë financime nga Banka Botërore kundrejt kostos së Projektit të Modernizimit të Asistencës Sociale dhe synon të aplikojë një pjesë të financimit për shërbimet e konsulencës **“Vlerësimi i gjendjes aktuale të përfituesve ekzistues të PAK-së, bazuar në analizën e të dhënave të siguruar nga baza e ngritur për të dhënat e PAK-së (kategoritë përfituese, niveli i përfitimit, dokumentacioni ligjor dhe mjekësor etj.)”.**

Shërbimet e konsulencës (shërbimet) përfshijnë informimin dhe këshillimin e përfituesve për gjendjen e personave me aftësi të kufizuara në bazën e të dhënave, për kategoritë që kanë statuse të veçanta dhe përfitimet e tyre në bazë të dosjeve të paaftësisë, diagnozës dhe sëmundshmërisë, sipas dosjeve të arkivuara, çfarë janë sëmundjet frekvente, periodiciteti, analiza e dosjeve, nëse ata kanë dokumentacion të rregullt dhe cilët nuk kanë fare dokumentacion, analiza e kategorive që përfitojnë nga statuset e dyfishta dhe të trefishta.

Vlerësimi do të përfshijë të gjitha kategoritë e përfituesve të DA-së, duke përfshirë: personat me aftësi të kufizuara mendore, fizike dhe shqisore, të verbër, paraplegjik dhe tetraplegjik, si dhe invalidët e punës.

Në bashkëpunim të ngushtë dhe nën mbikëqyrjen e Drejtorisë së Programeve të Zhvillimit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (që është agjencia zbatuese për SAMP-në), kompania vendëse do të jetë përgjegjëse, për:

1. Analizimin e të dhënave dhe të dokumentacionit të përfituesve me aftësi të kufizuara, në bazën e DA-së dhe identifikimin e boshllëqeve në dosjet e përfituesve;

2. Analizimin e të dhënave të gjeneruara nga MIS-ja me të dhënat e mbledhura zyrtarisht nga SHSSH-ja dhe sugjerimin e disa përmirësimeve në procesin e grumbullimit të të dhënave.

3. Këshillime mbi politikat dhe programet e ardhshme për rregullimin e DA-së bazuar në analizën e mësipërme.

Shërbimet do të kryhen nga një firmë konsulente me njohuri solide të praktikave më të mira në vend në sektorin social. Konsulenti duhet të provojë kryerjen e detyrave të ngjashme. Duhet të ketë një skuadër shumëdisiplinore, e cila ka përvojë dhe njohuri të konsiderueshme për mbrojtjen sociale, veçanërisht me programin e aftësive të kufizuara dhe mbi zhvillimet procedurale, institucionale dhe shoqërore në përgjithësi. Konsulenti duhet të ketë të paktën 5 vjet eksperiencë në këtë sektor.

Shërbimet kërkojnë një ekip të përbërë së paku nga një drejtues ekipi, ekspert social me përvojë të gjerë në fushën DA, një ekspert mjekësor me eksperiencë në administrimin e procesit të vlerësimit aktual të DA-së, një ekspert IT dhe një ekspert statistikash. Sidoqoftë, firma konsulente mund të punësojë ekspertë të tjerë për të zbatuar detyrën me standarde të larta.

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, nëpërmjet Njesisë së Menaxhimit të Projektit të Modernizimit të Asistencës Sociale, fton tashmë firma konsulente (konsulentët) të paraqesin interesin e tyre në realizimin e shërbimeve. Konsulentët e interesuar duhet të ofrojnë informacion që ata kanë kualifikimet e kërkuara dhe eksperiencën e duhur për realizimin e shërbimeve.



Kriteret e përfshirjes në listën e shkurtër janë:

Kriteret e listës së shkurtër	Pikët
Kualifikimet e përgjithshme të firmës (numri i viteve) në fushën e shërbimeve	20 pikë
Përshkrime të shërbimeve të ngjashme të kryera gjatë tri viteve të fundit	30 pikë
Eksperienca e përgjithshme dhe kualifikimet e stafit kryesor	10 pikë
Eksperienca të ngjashme dhe kualifikimet e stafit kryesor	40 pikë
TOTALI	100 pikë

Konsulentët e interesuar duhet të tregojnë vëmendje ndaj paragrafit 1.9 të udhëzimeve të Bankës Botërore: *Përzgjedhja dhe punësimi i konsulentëve sipas huave të IBRD-së, kredive të IDA-së dhe granteve nga huamarrësit e Bankës Botërore, të janarit 2011* (Udhëzimet për konsulentët), që përcakton politikën e Bankës Botërore mbi konfliktin e interesit.

Konsulenti duhet të jetë firmë vendëse. Një konsulent do të përzgjidhet në përputhje me metodën e përzgjedhjes së bazuar në Kualifikimet e konsulentit (CQ) të përcaktuara në udhëzuesit për konsulentët.

Konsulenti pritët të fillojë shërbimet në nëntor 2018 dhe t'i përfundojë në dhjetor 2018.

Informacion i mëtejshëm mund të merret në adresën më poshtë, gjatë orarit zyrtar, nga ora 08:00 deri në orën 16:30, nga e dita e hënë deri në ditën e enjte dhe nga ora 08:00 deri në orën 14:00, ditën e premte.

Shprehjet e interesit duhet të dorëzohen zyrtarisht në adresën më poshtë (dorazi ose me postë ose elektronikisht) deri më 7 nëntor 2018.

Njësia e Menaxhimit të Projektit (PMT)
Projekti i Modernizimit të Asistencës Sociale (SAMP)

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

Rruga e Kavajës, AL-1001, Tiranë

Në vëmendje: Suzana Papadhopulli

E-mail: samp.papadhopulli@gmail.com

NJOFTIM

Nr. 1065, datë 30.10.2018

PËR SHITJE ME ANKAND TË PRONËS SHTETËRORE NË ADMINISTRIM TË INSTITUTIT TË PËRGATITJES SË QENVE TË POLICISË, TIRANË

Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Drejtoria e Përgjithshme e Pronës Publike, Drejtoria e Drejtimit të Pronës Publike, në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 926, datë 29.12.2014, “Për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore, që privatizohet apo transformohet dhe procedurën e shitjes”, të ndryshuar, shpall për shitje me VAM fillestar, si më poshtë:

1. Në administrim të Institutit të Përgatitjes së Qeneve të Policisë, Tiranë

Nr.	Emërtimi	Datëlindja	Vendndodhja	Vlera fillestare e ankandit në lekë	Zhvillimi i ankandit		
					Data	Ora	Vendi
1	Qeni Doner	3.10.2017	Tiranë	15,000	26.11.2018	09:00	DDPP
2	Qeni Tomi	4.11.2017	Tiranë	15,000	26.11.2018	09:15	DDPP
3	Qeni Kleo	12.5.2017	Tiranë	15,000	26.11.2018	09:30	DDPP
4	Qeni Koko	12.5.2017	Tiranë	15,000	26.11.2018	09:45	DDPP
5	Qeni Dakota	3.10.2017	Tiranë	15,000	26.11.2018	10:00	DDPP
6	Qeni Jona	3.10.2017	Tiranë	15,000	26.11.2018	10:15	DDPP
7	Qeni Diva	3.10.2017	Tiranë	15,000	26.11.2018	10:30	DDPP
8	Qeni Orsa	3.10.2017	Tiranë	15,000	26.11.2018	10:45	DDPP
9	Qeni Dona	10.10.2017	Tiranë	15,000	26.11.2018	11:00	DDPP
10	Qeni Xara	4.11.2017	Tiranë	15,000	26.11.2018	11:15	DDPP
11	Qeni Maja	7.5.2017	Tiranë	15,000	26.11.2018	11:30	DDPP
12	Qeni Luna	12.5.2017	Tiranë	15,000	26.11.2018	11:45	DDPP
13	Qeni Dana	23.9.2016	Tiranë	15,000	26.11.2018	12:00	DDPP
14	Qeni Maxhi	7.5.2016	Tiranë	15,000	26.11.2018	12:15	DDPP
15	Qeni Lata	15.9.2012	Tiranë	15,000	26.11.2018	12:30	DDPP
16	Qeni Viola	4.6.2010	Tiranë	8,000	26.11.2018	12:45	DDPP
17	Qeni Sonja	10.6.2010	Tiranë	8,000	26.11.2018	13:00	DDPP
18	Qeni Pana	18.5.2012	Tiranë	10,000	26.11.2018	13:15	DDPP
19	Qeni Pata	17.3.2012	Tiranë	10,000	26.11.2018	13:30	DDPP
20	Qeni Bllek	24.11.2014	Tiranë	12,000	26.11.2018	13:45	DDPP
21	Qeni Busan	15.11.2010	Tiranë	8,000	26.11.2018	14:00	DDPP



Çdo person fizik apo juridik i interesuar për blerje duhet të paraqesë në vendin, datën dhe orën e njoftuar, pranë komisionit të ankandit, dokumentacionin si më poshtë:

1. **Kërkesë me shkrim** për blerje, e regjistruar pranë protokollit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

2. **Garancinë bankare apo mandatpagesën** në original, që vërteton ngurtësimin e 20% të vlerës së fillimit të ankandit, në lekë, për llogari të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

3. **Dokument identifikimi** (pasaportë biometrike ose letërnjoftim).

Shënim. Pjesëmarrësit në ankand, i cili tërhiqet nga ankandi pa dhënë asnjë ofertë për vlerën shpallur për shitje, i konfiskohet 20% e garancisë bankare, e ngurtësuar për pjesëmarrje në ankand.

Garancia bankare apo mandatpagesa duhet të bëhet detyrues brenda afatit të pranimit të kërkesave për pjesëmarrje në ankand. Garancia bankare apo mandatpagesa mund të bëhen pranë çdo banke të nivelit të dytë, në llogaritë respektive të hapura për Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, pasi të keni tërhequr pranë DDPP-së ose degëve të thesarit në rrethe, faturën për arkëtim të plotësuar dhe të nënshkruar nga përfaqësuesi i institucionit.

Këto informacione gjenden edhe në faqen e internetit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë: www.financa.gov.al

NJOFTIM

Nr. 1065, datë 30.10.2018

PËR SHITJE ME ANKAND TË PRONËS SHTETËRORE NË ADMINISTRIM: TË MINISTRISË SË BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL; TË BASHKISË BAJRAM CURRI; TË SHOQËRISË “ALBMINIERA” SHA; TË DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË REZERVAVE MATERIALE TË SHTETIT, SI DHE TË BASHKISË PËRMET

Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Drejtoria e Përgjithshme e Pronës Publike, Drejtoria e Drejtimit të Pronës Publike, në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 926, datë 29.12.2014, “Për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore, që privatizohet apo transformohet dhe procedurën e shitjes”, kapitulli III, shpall për shitje me VAM fillestar, si më poshtë:

1. Në administrim të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

Nr.	Emërtimi i objektit	Vendndodhja	Vlerat (në lekë)			Sipërfaqja e përgjithshme (m ²)	Sipërfaqja nën objekt (m ²)	Zhvillimi i ankandit		
			Vlera fillestare e ankandit (Mjete kryesore + truall)	Mjetet kryesore	Truall			Data	Ora	Vendi
1	Objekte të Agjencisë Kombëtare të Duhan-Cigareve	Cërrik	24 740 466	22 258 310	2 482 156	5 924	1 344	27.11.2018	10:00	DDPP

2. Në administrim të Bashkisë Bajram Curri

Nr.	Emërtimi i objektit	Vendndodhja	Vlerat (në lekë)			Sipërfaqja e përgjithshme (m ²)	Sipërfaqja nën objekt (m ²)	Zhvillimi i ankandit		
			Vlera fillestare e ankandit (mjete kryesore + truall)	Mjetet kryesore	Truall			Data	Ora	Vendi
1	Ish-Këshilli Popullor	Bajram Curri	10 589 108	9 961 653	627 455	335	263.3	27.11.2018	11:00	DDPP



3. Në administrim të shoqërisë “Albminiera” sh.a.

Nr.	Emërtimi i objektit	Vendndodhja	Vlerat (në lekë)			Sipërfaqja e përgjithshme (m ²)	Sipërfaqja nën objekt (m ²)	Zhvillimi i ankandit		
			Vlera fillestare e ankandit (mjete kryesore + truall)	Mjetet kryesore	Truall			Data	Ora	Vendi
1	Magazinë qendrore	Memaliaj, Tepelenë	11 426 394	10 929 894	496 500	3 972	424.8	27.11.2018	12:00	DDPP

4. Në administrim të Drejtorisë së Përgjithshme të Rezervave Materiale të Shtetit

Nr.	Emërtimi i objektit	Vendndodhja	Vlerat (në lekë)				Sipërfaqja e përgjithshme (m ²)	Sipërfaqja nën objekt (m ²)	Zhvillimi i ankandit		
			Vlera fillestare e ankandit (mjete kryesore + truall)	Ndërtesa	Makinëri dhe pajisje	Truall			Data	Ora	Vendi
1	Objekte të Agjencisë së Rezervave të Shtetit	Fusha e Peshtanit, Berat	31 500 097	21 609 041	2 083 700	7 807 356	4 932	1 657	27.11.2018	13:00	DDPP

5. Në administrim të Bashkisë Përmet

Nr.	Emërtimi i objektit	Vendndodhja	Vlerat (në lekë)			Sipërfaqja e përgjithshme (m ²)	Sipërfaqja nën objekt (m ²)	Zhvillimi i ankandit		
			Vlera fillestare e ankandit (mjete kryesore + truall)	Mjetet kryesore	Truall			Data	Ora	Vendi
1	Stalla e derrave	Kutal, Përmet	3 673 849	3 510 571	163 278	846	156	27.11.2018	14:00	DDPP

Çdo person fizik apo juridik i interesuar për blerje me ankand duhet të paraqesë në vendin, datën dhe orën e njoftuar, pranë komisionit të ankandit, dokumentacionin si më poshtë:

1. **Kërkesë me shkrim** për blerjen e objektit apo të ndërmarrjes, e regjistruar pranë protokollit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

2. **Mandatpagesën apo garancinë bankare** në origjinal, që vërteton derdhjen apo ngurtësimin e 20% të vlerës së fillimit të ankandit, në lekë, për llogari të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

3. **Dokument identifikimi** (pasaportë biometrike ose letërnjoftim).

Shënim. Pjesëmarrësit në ankand, i cili tërhiqet nga ankandi pa dhënë asnjë ofertë për vlerën e objektit të shpallur për shitje, nuk i

kthehet 20% e vlerës fillestare, të ngurtësuar për pjesëmarrje në ankand.

Subjekti i shpronësuar i truallit, mbi të cilin ndodhet objekti apo ndërmarrja, duhet të paraqesë në vendin, datën dhe orën e njoftuar pranë komisionit të ankandit, dokumentacionin si më poshtë:

1. **Kërkesë me shkrim** për blerjen e objektit apo të ndërmarrjes, e regjistruar pranë protokollit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

2. **Mandatpagesën apo garancinë bankare**, që vërteton ngurtësimin e 20 për qind të vlerës fillestare në lekë, vetëm për objektin (mjete kryesore), për llogari të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, në Drejtorinë e Drejtimit të Pronës Publike, detyrimisht brenda afatit të pranimit të kërkesave.



3. **Vendimin e Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave**, të shoqëruar me planvendosjen e pronës, ku përcaktohet se ai është subjekt pronar i tokës.

4. **Dëshminë e trashëgimisë**, prokurë përfaqësimi etj., nëse ka të tilla.

5. **Deklaratë noteriale**, në të cilën trashëgimtarët e subjektit të shpronësuar që kërkojnë të ushtrojnë të drejtën e parablerjes për objektin në proces privatizimi, të deklarojnë, se, që nga momenti që janë pajisur me vendimin e Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, nuk kanë përfituar kompensim në asnjë nga format e parashikuara në ligj. Gjithashtu, të deklarojnë se vendimi i ish-Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave ose i Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, nuk ka ndryshuar ose është shfuqizuar me ndonjë akt administrativ apo vendim të formës së prerë.

Mandatpagesa apo garancia bankare duhet të bëhet detyrues brenda afatit të pranimit të kërkesave për pjesëmarrje në ankand. Mandatpagesa apo garancia bankare mund të bëhen pranë çdo banke të nivelit të dytë, në llogaritë respektive të hapura për Ministrinë e

Financave dhe Ekonomisë, pasi të keni tërhequr pranë DDPP-së ose degëve të thesarit në rrethe, faturën për arkëtim, të plotësuar dhe të nënshkruar nga përfaqësuesi i institucionit.

Këto informacione gjenden edhe në faqen e internetit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë: www.financa.gov.al

NJOFTIM

Nr. 1072, datë 30.10.2018

PËR SHITJE ME ANKAND TË PRONËS SHTETËRORE NË ADMINISTRIM TË DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË REZERVAVE MATERIALE TË SHTETIT

Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Drejtoria e Përgjithshme e Pronës Publike, Drejtoria e Drejtimit të Pronës Publike, në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 926, datë 29.12.2014, “Për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore, që privatizohet apo transformohet dhe procedurën e shitjes”, të ndryshuar, kapitulli III, pika 2, germa “c”, shpall për shitje me VAM fillestar, si më poshtë:

1. Në administrim të Drejtorisë së Përgjithshme të Rezervave Materiale të Shtetit

Nr.	Emërtimi i objektit	Vend-ndodhja	Vlerat (në lekë)			Sipërfaqja e përgjithshme (m ²)	Sipërfaqja nën objekt (m ²)	Zhvillimi i ankandit		
			Vlera fillestare e ankandit (mjete kryesore + truall)	Mjetet kryesore	Truall			Data	Ora	Vendi
1	Objekte të Agjencisë Maqellarë, të Drejtorisë Rajonale të Rezervave Materiale të Shtetit, Mat	Maqellarë, Dibër	43 744 160	43 591 140	153 020	1 093	1 093	18.9.2018	10:00	DDPP

Subjekti i shpronësuar i truallit, mbi të cilin ndodhet objekti apo ndërmarrja, duhet të paraqesë brenda afatit të publikimit pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Drejtoria e Drejtimit të Pronës Publike, dokumentacionin si më poshtë:

1. **Kërkesë me shkrim** për blerjen e objektit apo të ndërmarrjes, e regjistruar pranë protokollit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

2. **Mandatpagesën apo garancinë bankare** që vërteton ngurtësimin e 20 për qind të vlerës fillestare në lekë, vetëm për objektin (mjete kryesore), për llogari të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë në Drejtorinë e Drejtimit të Pronës Publike, detyrues brenda afatit të pranimit të kërkesave.



3. **Vendimin e Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave**, të shoqëruar me planvendosjen e pronës, ku përcaktohet se ai është subjekt pronar i tokës.

4. **Dëshminë e trashëgimisë**, prokurë përfaqësimi etj., nëse ka të tilla.

5. **Deklaratë noteriale**, në të cilën trashëgimtarët e subjektit të shpronësuar, që kërkojnë të ushtrojnë të drejtën e parablerjes për objektin në proces privatizimi, të deklarojnë, se, që nga momenti që janë pajisur me vendimin e Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, nuk kanë përfituar kompensim në asnjë nga format e parashikuara në ligj. Gjithashtu, të deklarojnë se vendimi i ish-Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave ose i Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, nuk ka ndryshuar ose është shfuqizuar me ndonjë akt administrativ apo vendim të formës së prerë.

Mandatpagesa apo garancia bankare duhet të bëhet detyrues brenda afatit të publikimit. Mandatpagesa apo garancia bankare mund të bëhen pranë çdo banke të nivelit të dytë, në llogaritë respektive të hapura për Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, pasi të keni tërhequr pranë DDPP-së ose degëve të thesarit në rrethe, faturën për arkëtim, të plotësuar dhe të nënshkruar nga përfaqësuesi i institucionit.

Shënim. Publikimi bëhet për ish-pronarët e truallit, subjektit të shpronësuar Sabri Kadriu (Nasufi).

Afati i publikimit fillon në datën 29.10.2018 dhe mbaron në datën 28.11.2018.

KËRKESË

Nr. 1871, datë 1.11.2018

PËR BOTIMIN E VENDIMIT PËR DËNIM ADMINISTRATIV, NDAJ SUBJEKTIT “LIRIJE BAKIRI”, ME NIPT: L52109129A

ISHMPUT-ja, Dega Rajonale Tiranë, megjithëse ka realizuar njoftimin zyrtar për vendimin administrativ përfundimtar të Komisionit të Shqyrtimit të Ankimit, nëpërmjet shërbimit postar është kthyer njoftimi i institucionit tonë, duke u konfirmuar nga shërbimi postar, largimi i subjektit nga ajo adresë apo adresë jo e saktë.

Sa më sipër, ISHMPUT-ja, Dega Rajonale Tiranë, bën njoftimin publik të vendimit të dënimit administrativ, respektivisht për subjektin si më poshtë:

1. “Lirije Bakiri”, me NIPT: L52109129A

KRYEINSPEKTOR I NGARKUAR
NË DETYRË
ISHMPUT, DEGA TIRANË
Evisjon Salku



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TURIZMIT DHE MJEDISIT
INSPEKTORATI SHTETËROR I MJEDISIT PYJEVE DHE UJËRAVE

Nr. Serial: 0000739

VENDIMI PËRFUNDIMTAR I INSPEKTIMIT

Nr. 04, datë 09.10.2018

Inspektorët e ISHMPU-së, pas ushtrimit të kontrollit mbi veprimtarinë e personit fizik/juridik, "Lirije Bakiri", në mbështetje të nenit 46 e vijim, të ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011, "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë" dhe në zbatim të pikës 6, të nenit 32, të ligjit nr. 9174, datë 11.07.2008 "Për Vlerësimin dhe Administrimin e Zhurmës në Mjedis". referuar shkeljeve të pasqyruara në Proces - verbalin e inspektimit me Nr. Serie 000477, datë 08/10/2018, të cilat përbëjnë kundërvajtje administrative:

VENDOSA:

1. Të dënojmë me Gjobë në vlerën : 5.000 lekë (Pesë mijë Lekë)

2. Të dënojmë me "Paralajmërim", si dënim administrativ kryesor.

Një nga dy dënimet kryesore të mësipërme, si dhe një ose disa nga dënimet plotësuese të mëposhtëme:

3. Të pezullojë pjesërisht ose plotësisht aktivitetin: pezhorimi i burimit të zhurmës dhe
pezhorimi i mjedisit për mjedisin

4. Të sekuestrojë pajisjet, mjetet dhe lëndët e mëposhtëme:

5. Të propozojë revokimin e lejes me Nr. Identifikimi _____, datë ____/____/____

6. Të korrigjojë shkeljet e konstatuara dhe t'i raportojë strukturës urdhëruese brenda datës ____/____/____

7. Të paguajë shpenzimet e analizave të mostrave në vlerën _____ lekë (.....)

Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim drejtuar Komisionit të Ankimit të ISHMPU, brenda 30 ditëve nga marrja e njoftimit. Ky vendimi mbahet në katër kopje.

INSPEKTORËT E AUTORIZUAR TË ISHMPU

1. Drita Mehmeti; ID _____; (DM)

2. Amir Kuci; ID _____; (AK)

3. _____; ID _____; ()

(Emër, mbiemër, ID, nënshkrimi)

**KËRKESË****Nr. 1872, datë 1.11.2018****PËR BOTIMIN E VENDIMIT PËR
DËNIM ADMINISTRATIV, NDAJ
SUBJEKTIT “IN-MA” sh.p.k.**

ISHMPUT-ja, Dega Rajonale Tiranë, megjithëse ka realizuar njoftimin zyrtar për vendimin administrativ përfundimtar të Komisionit të Shqyrtimit të Ankimit, nëpërmjet shërbimit postar është kthyer njoftimi i institucionit tonë, duke u konfirmuar nga

shërbimi postar, largimi i subjektit nga ajo adresë apo adresë jo e saktë.

Sa më sipër, ISHMPUT-ja, Dega Rajonale Tiranë, bën njoftimin publik të vendimit të dënimit administrativ, respektivisht për subjektin si më poshtë:

“IN-MA” sh.p.k.

KRYEINSPEKTOR I NGARKUAR
NË DETYRË
ISHMPUT, DEGA TIRANË
Evisjon Salku

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TURIZMIT DHE MJEDISIT
INSPEKTORATI SHTETËROR I MJEDISIT, PYJEVE, UJËRAVE DHE TURIZMIT**

Nr. 4816 prot.**Tiranë, datë 13.9.2018****VENDIM****I KOMISIONIT TË ANKIMIT**

Në bazë të pikës 2, të nenit 51, të ligjit nr. 10433, datë 16.6.2011, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”; të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 103, datë 4.2.2015, “Për krijimin dhe mënyrën e organizimit e të funksionimit të Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit dhe Pyjeve”, të ndryshuar me vendimin nr. 338, datë 6.6.2018, të Këshillit të Ministrave dhe të ankimit për vendimin përfundimtar me **nr. 3, datë 11.5.2018, të ISHMPUT-së, Dega Rajonale Tiranë**, ndaj subjektit **“IN-MA” sh.p.k.**, protokolluar me nr. 2458 prot., datë 18.5.2018.

Komisioni:

Sa më sipër, nga analiza e fakteve të pretenduara nga të dyja palët, arsyeton se marrja e masës administrative nga grupi i inspektimit është në përputhje me germën “a/iii”, të pikës 1, të nenit 29, të ligjit nr. 10 448, datë 14.7.2011, “Për lejet e mjedisit”, të ndryshuar. Pasi shqyrtoi ankesën e subjektit dhe masën administrative, në mbështetje të pikës 4, të nenit 137, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”,

VENDOSI:

Lënien në fuqi të vendimit të dënimit nr. 3, datë 11.5.2018, në vlerën 400,000 lekë dhe pezullimin plotësisht të aktivitetit, dhe rrëzimin e ankimit të subjektit ndaj këtij akti administrativ.

Ky akt hyn në fuqi menjëherë.

KRYEINSPEKTOR
I komanduar në detyrë
Armando Lamaj

Kundër vendimit përfundimtar mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë.

**KËRKESË****Nr. 1873, datë 1.11.2018****PËR BOTIMIN E VENDIMIT PËR
DËNIM ADMINISTRATIV, NDAJ
SUBJEKTIT
“BAR TE LATIN DANCE CENTER”**

ISHMPUT-ja, Dega Rajonale Tiranë, megjithëse ka realizuar njoftimin zyrtar për vendimin administrativ përfundimtar të Komisionit të Shqyrtimit të Ankimit, nëpërmjet shërbimit postar është kthyer njoftimi i institucionit tonë, duke u konfirmuar nga

shërbimi postar, largimi i subjektit nga ajo adresë apo adresë jo e saktë.

Sa më sipër, ISHMPUT-ja, Dega Rajonale Tiranë, bën njoftimin publik të vendimit të dënimit administrativ, respektivisht për subjektin si më poshtë:

“Bar Te Latin Dance Center”

KRYEINSPEKTOR I NGARKUAR
NË DETYRË,
ISHMPUT, DEGA TIRANË
Evisjon Salku

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TURIZMIT DHE MJEDISIT
INSPEKTORATI SHTETËROR I MJEDISIT, PYJEVE, UJËRAVE DHE TURIZMIT**

Nr. 4820 prot.**Tiranë, datë 13.9.2018****VENDIM****I KOMISIONIT TË ANKIMIT**

Në bazë të pikës 2, të nenit 51, të ligjit nr. 10433, datë 16.6.2011, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”; të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 103, datë 4.2.2015, “Për krijimin dhe mënyrën e organizimit e të funksionimit të Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit dhe Pyjeve”, të ndryshuar me vendimin nr. 338, datë 6.6.2018, të Këshillit të Ministrave dhe të ankimit për vendimin përfundimtar me **nr. 1, datë 2.6.2018, të ISHMPUT-së, Dega Rajonale Tiranë**, ndaj subjektit “**Te Latin Dance Center**”, protokolluar me nr. 2875 prot., datë 5.6.2018,

Komisioni:

Sa më sipër, nga analiza e fakteve të pretenduara nga të dyja palët, arsyeton se marrja e masës administrative nga grupi i inspektimit është në përputhje me germën “a”, të pikës 1, të nenit 32, të ligjit nr. 9774, datë 12.7.2007, “Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis”. Pasi shqyrtoi ankesën e subjektit dhe masën administrative, në mbështetje të pikës 4, të nenit 137, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”,

VENDOSI:

